



VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 23 nëntor 2011

Numri i lëndës 2011-22

z. Hysni Gashi dhe z. Feriz Gashi

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar më 30 qershor 2011.

II. THE FACTS

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesit e ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panelit, mund të përmblidhen si në vijim.

3. Më 22 prill 2006 parashtruesit e ankesës kishin shtënë në dy persona dhe ishin përpjekur të vrisnin disa të tjera në një ballkon të një kafeneje në Shtime.
4. Pas hetimeve, ishte ngritur aktakuzë nga prokurori në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës më 10 janar 2007.
5. Rasti ishte marrë përsipër nga EULEX-i në dhjetor 2008, pas një kërkese nga njëri prej parashtruesve të ankesës. Deri atëherë, janë mbajtur gjithsej tetë (8) seanca dëgjimore dhe një vizitë në vendin e krimtit, meqenëse ishte ngritur një aktakuzë në Gjykatën e Qarkut.
6. Gjykimi kryesor kishte filluar me dy gjykatës të EULEX-it në një trup gjykues prej tre gjykatësve më 11 shkurt 2009. Janë mbajtur edhe gjashtë (6) seanca dëgjimorë të tjera.
7. Më 27 mars 2009, të dy parashtruesit të ankesës ishin dënuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës për vrasje të rëndë, aktakuzë për vrasje të rëndë dhe vepra të tjera penale. Ata ishin dënuar me nga njëzet e pesë (25) vite e gjashtë (6) muaj, dhe përkatësisht njëzet (20) vite në burg. Koha e kaluar në paraburgim ishte llogaritur si kohë e vuajtjes së dënimit.
8. Sipas njohurive të Panelit, nuk ishte paraqitur ndonjë ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

III. ANKESAT

9. Parashtruesit e ankesës pohojnë se kryesuesi i trupit gjykues, një gjykatës i EULEX-it kishte vepruar në mënyrë jo të duhur, kështu që gjykata kishte nxjerrë një vendim joligjor përkundër të gjitha provave që tregonin pafajësinë e parashtruesve të ankesës, dhe se EULEX-i mbështet dhe mbron kriminelët për interesat e tij.

IV. LIGJI

10. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të Punës.
11. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtës, polici dhe dogana, sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së vet të Punës.
12. Sipas Rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhënieve në PLANIN OPERATIV të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore të gjykatave të Kosovës. Për

më tepër, nuk është detyrë e Panelit që të merret me gabimet e fakteve ose ligjit që dyshohet se janë kryer nga një gjykatë në Kosovë, përveç apo në atë masë sa ata mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga konventat e të drejtave të njeriut të zbatueshme në Kosovë.

13. Ankesa ka të bëjë me procedurat ligjore të zhvilluara nga një gjykatë në Kosovë. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues që janë të caktuar për ta shqyrtuar rastin nuk ia mohon gjykatave natyrën e tyre si pjesë të sistemit juridik të Kosovës.
14. Paneli nuk ka kompetenca as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës dhe legjislacionit që zbatohet nga ta apo vendimet e nxjerrë nga ta. Vendimet e gjykatave të Kosovës i nënshtrohen ankesave dhe ekzistojnë mjete të jashtëzakonshme juridike sipas ligjit në fuqi. Nuk është treguar se parashtruesit e ankesës i kanë shtetur të gjitha procedurat për ankesë rreth rastit në fjalë.
15. Si pasojë, çështja e ngritur në këtë pjesë të ankesës nuk bie brenda mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, siç është e përcaktuar në Rregulloren 25 të Rregullores së Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.
16. Për më tepër, në përputhje me Rregulloren 25, paragrafi 3 i RrP1, ankesat duhet të dorëzohen brenda tre muajve nga data kur Paneli mund të pranoj ankesat (9 qershor 2010), apo brenda gjashtë muajve nga data e ndonjë shkelje të dyshuar, cilado do të ishte më e përshtatshme për parashtruesin e ankesës.
17. Vendimi përfundimtar në rastin e parashtruesve të ankesës ishte marrë më 27 mars 2009. Kjo ankesë i ishte parashtruar Panelit më 30 qershor 2011. Në përputhje me Rregulloren 25, paragraplin 3 të Rregullores së Punës, ankesa duhet të ishte parashtruar jo më vonë se data 20 shtator 2010. Prandaj ankesa nuk i plotëson kriteret rreth pranueshmërisë së saj, të përcaktuara në Rregulloren 29 të RrP.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI,

konstaton se ankesa ishte parashtruar në Panel jashtë afatit kohor të përcaktuar në Rregulloren e vet të Punës, dhe në çfarëdo rast, Paneli nuk ka kompetencë për të shqyrtuar këtë ankesë,

gjen se kjo ankesë është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, dhe

¹ Siç paraqitet në versionin e datës 9 qershor 2010, në fuqi në kohën e parashtrimit të kësaj ankesë.

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit